



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT  
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR  
DREJTORIA RAJONALE E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR  
ZYRA VENDORE E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR

Nr. 1270/1 Prot.

Fier, më 28.08.2023

Lënda: Njoftim për zhvillimin e praktikës profesionale në profesionin e rregulluar të mësuesit për vitin mësimor 2023-2024

Në zbatim të ligjit nr.69/2012, datë 21.06.2012 "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, ligjit nr. 10171, datë 22.10.2009 "Për profesionet e rregulluara në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, Udhëzim nr.14, datë 10.07.2023 "Për numrin e nxënësve për klasë dhe normat e punës mësimore në institucionet e arsimit parauniversitar", i ndryshuar, Urdhrit nr.100, datë 25.02.2022 Për miratimin e Rregullores "Për organizimin dhe zhvillimin e praktikave profesionale për profesionin e rregulluar të mësuesit", shkresës me nr.5245 prot, datë 22.08.2023 "Për zhvillimin e praktikës profesionale në profesionin e rregulluar të mësuesit për vitin mësimor 2023-2024, ZVAP Fier ju bën me dije se aplikimi për zhvillimin e praktikës profesionale për profesionin e rregulluar të mësuesisë do të kryhet nëpërmjet platformës së aplikimit online e-albania.

**Kandidatët kanë të drejtë të zhvillojnë praktikën profesionale në një nga tri periudhat mësimore.**

Afati i regjistrimit të kandidatëve nëpërmjet platformës e-albania që do të zhvillojnë praktikën profesionale për profesionin e rregulluar të mësuesit, në periudhën e parë mësimore është nga data **28.08.2023-07.09.2023**, në periudhën e dytë mësimore është nga data **04.12.2023-15.12.2023** dhe në periudhën e tretë mësimore është nga data **05.03.2024-15.03.2024**.

Kandidati i interesuar për zhvillimin e praktikës profesionale ngarkon në platformën online e-albania dokumentet si më poshtë:

1.

- a. Jetëshkrimi (cv) i praktikantit;
- b. Dokumenti i identitetit (ID);
- ç. Diplomat në fushën e mësuesisë ose diploma të njëvlershme me to, sipas përcaktimeve në ligjin nr.80 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", dhe listën e notave për secilën diplomë;
- c. Raportin mjeko-ligjor;

2. Dokumentet e sipërcituara janë të detyrueshme dhe duhet të jenë të skanuara nga origjinali.

Adresa: Rr.Leon Rei, Fier

e-mail: ZVAfier@arsimi.gov.al



3. Kandidati i interesuar për të zhvilluar praktikën profesionale, dosja e të cilit nuk përmban dokumentet e detyrueshme për t'u ngarkuar në platformën online, përjashtohet nga pjesëmarrja për zhvillimin e praktikës profesionale.

4. Nëse kandidati i interesuar për të zhvilluar praktikën profesionale ngarkon në platformën e aplikimit online dokumente që dyshohet se janë të falsifikuara, përjashtohet nga pjesëmarrja për zhvillimin e praktikës profesionale. Rasti referohet në organet kompetente.

**DREJTOR**

**Zaira Gjika**



---

Adresa: Rr.Leon Rei, Fier

e-mail: ZVAfier@arsimi.gov.al